



Në bazë të nenit 7, alineja 9 nga Ligji për themelim të Agjencisë për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 72/07, 5/09, 43/14, 193/15, 39/16, 164/18 dhe 190), Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural e publikon këtë:

THIRRJE PUBLIKE nr. 01/2020
për parashtrim të kërkesave për shfrytëzim të mjeteve nga
Programi për mbështetje financiare në Peshkatari dhe Akuakulturë për vitin 2020

I. LËNDA E THIRRJES PUBLIKE

Lëndë e kësaj shpallje është shpërndarja e mbështetjes financiare për nënpikat e masave në vijim:

Masa 2	Mbështetja financiare në akuakulturë	Mjetet	Vlerat maksimale të shpenzimeve të pranueshme
Nënpika 2.1	Mbështetja financiare për investimet në akuakulturë	15.000.000,00 denarë	7.000.000,00 denarë për shfrytëzues individual
	- Ndërtimi i kapaciteteve të reja për akuakulturë		
	- Zgjerimi, rekonstruktimi, adaptimi dhe modernizimi i kapaciteteve ekzistuese për akuakulturë		
	- Ndërtimi i kapaciteteve të reja për përpunimin e peshqve		
	- Furnizimi i pajisjes për përpunim, ripërpunim, deponim dhe paketim të peshqve		

II. SHFRYTËZUES

Të drejtë për shfrytëzimin e mjeteve kanë subjektet në vijim, edhe atë për nënpikat:

Subjekti	Nënpika
Shfrytëzues të mjeteve të parapara për ndërtim të kapaciteteve të reja për akuakulturë janë: Subjekte të cilat janë të regjistruara për veprimtari akuakulturë dhe posedojnë ose shfrytëzojnë pronë të patundshme në të cilin planifikojnë të ndërtojnë kapacitet për akuakulturë; ose posedojnë leje për shfrytëzim të ujit për vendosje në kafaze në zonat e parapara për akuakulturë	2.1
Shfrytëzues të mjeteve të parapara për zgjerim, rekonstruktiv, adaptim dhe modernizim të kapaciteteve ekzistuese për akuakulturë janë: Subjektet të cilat janë të regjistruara për veprimtari akuakulturë, dhe janë të regjistruara në regjistrin e mirëmbajtësve të peshqve që udhëhiqet në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave;	2.1
Shfrytëzues të mjeteve të parapara për ndërtimin e kapaciteteve të reja për përpunimin e peshqve janë: Subjekte të cilat janë në rangun e ndërmarrjeve mikro, të vogla ose të mesme të regjistruara për veprimtari akuakulturë dhe posedojnë ose shfrytëzojnë pronë të patundshme në të cilin planifikojnë të ndërtojnë kapacitetet riprodhuese;	2.1
Shfrytëzues të mjeteve të parapara për furnizim të pajisjes për përpunim, ripërpunim, deponim dhe paketim të peshqve janë subjekte të cilat janë në rangun e ndërmarrjeve mikro, të vogla ose të mesme të cilat posedojnë objekt të paraparë për përpunimin e peshqve.	2.1

III. SHUMA E MBËSHETJES FINANCIARE

Mjetet janë të dedikuara për investime për furnizim të mjeteve të reja themelore, harxhime operative në lidhje me mjetet e furnizuara dhe harxhime të tjera të parapara me Programin për përkrahje financiare në peshkatari dhe akuakulturë për vitin 2020 (Gazeta Zyrtare nr.277/19).

Për Masën 2.1, përkrahja financiare paguhet me princip të bashkëfinancimit të investimeve përfundimtare dhe të paguara nga ana e shfrytëzuesit në shumë prej 50% nga vlera e harxhimeve të lejuara/të pranueshme për investime. Shkalla e bashkëfinancimit rritet deri në 55%, 60% dhe 65% në rastet kur:

- 55% nga vlera e investimit të lejuar, për investime të dërguara nga dërgues i ekonomisë bujqësore prej moshës 18 vjeçare deri në moshën 40 vjeçare në ditën e dorëzimit të investimit ose grua bartëse e ekonomisë bujqësore;
- 60% nga vlera e investimit të lejuar, për investime në ekonomi bujqësore e cila gjendet në vende rurale kodrinoro-malore;
- 65% nga vlera e investimit të lejuar, për investime të dërguara nga dërgues i ekonomisë bujqësore prej moshës 18 vjeçare deri në moshën 40 vjeçare në ditën e dorëzimit të investimit ose grua bartëse e ekonomisë bujqësore që gjendet në vendet rurale kodrinoro-malore.

Mbështetja financiare e ndarë financiare është e pakthyeshme.

IV. KUSHTET PËR SHFRYTËZIM TË MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI I CILI PARASHTROHET

Kërkesa për secilën nënpikë dorëzohet në original.

Kushtet të cilat duhet t'i plotësojnë kërkesit e mjeteve janë të vërtetuara në Programin për përkrahje financiare në peshkatari dhe akuakulturë për vitin 2020 (Gazeta Zyrtare nr.277/19).

Nëse në Agjenci dorëzohen më shumë kërkesa se sa ka mjete të disponueshme në pajtim me Programin për përkrahje financiare në peshkatari dhe akuakulturë për vitin 2020, Agjencia do tu japë përparësi atyre kërkuësve që kanë dorëzuar kërkesën e tyre më herët se të tjerët.

Kërkuësit nuk guxojnë të fillojnë me realizimin e investimit para nënshkrimit të Marrëveshjes për bashkëfinancim me Agjencinë për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillimin rural.

V. TËRHEQJA E FORMULARËVE DHE UDHËZIMET

Formularët "Kërkesë për shfrytëzimin e mjeteve" (Formulari PRA-A1) me listën e dokumenteve të nevojshme dhe Udhëzimin për shfrytëzuesit mund të merret në ueb faqen e Agjencisë www.ipardpa.gov.mk në pjesën Peshkatari dhe akuakulturë 2020.

Formularët e lartpërmendur mund të merren edhe drejtpërdrejtë në Agjenci në adresë çdo ditë pune prej ora 8:30 deri në ora 16:30:

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, Bul. "3-ta Makedonska Brigada" nr. 20 (ndërtesa e Makedonija Tabak blloku C) 1000 Shkup

VI. MËNYRA E DORËZIMIT TË DOKUMENTEVE

Kërkesat e plotësuara për mbështetje financiare dhe shfrytëzim të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare në peshkatari dhe akuakulturë për vitin 2020 në gjuhën maqedonase së bashku me tërë dokumentacionin e duhur dorëzohen në zarf të mbyllur me shënim në këndin e majtë lart të anës së përparme të zarfit "MOS HAP" për Thirrjen publike nr. 01/2020 dhe shënimin e shifrës së nënpikës për të cilën dorëzohet kërkesa. Kërkesa mund të dorëzohet përmes postës ose personalisht në sportelin e Agjencisë, në të kundërtën Agjencia nuk merr përgjegjësi për humbjen apo hapjen e parakohshme të kërkesës.

Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave është 22.03.2020.

Kërkesat e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk do të merren në shqyrtim

Informata më të hollësishme në kontakt tel. (02) 3097- 460 ose në kontakt e-mail adresën: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk dhe në ueb-faqen: www.ipardpa.gov.mk

Kontakt:

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, Sektori për aprovim të projekteve, Sektori për miratimin e pagesës.

Telefon: 02/3097-460, çdo ditë pune nga ora 08.30 deri 16.30.

E-mail: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk



AGJENCIA PËR MBËSHTETJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIMIN RURAL